



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0449

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE “Sinjal” SH.P.K., me seli në Ferizaj, kundër Vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK)- Komuna e Prishtinës, më 04/09/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE “Sinjal” SH.P.K. me nr. 2023/0449, e datës 30/06/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale”, me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Komuna e Prishtinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 19.10.2022, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte me datë 29.11.2022. Me datë 13.06.2023, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale”, me numër të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, ku është rekomanduar për kontratë, OE “Select Prima” sh.p.k. Prishtinë.

Me datë 17.06.2023, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 23.06.2023, AK Komuna e Prishtinës, refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “SINJAL” Sh.p.k për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, “ SINJAL” Sh.p.k me seli në Ferizaj, me datën 03.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 449/23.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur lloji i kontratës - shërbime, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët vlera e parashikuar e kontratës: 160,000.00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 07.07.2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 17.07.2023, AK Komuna e Prishtinës, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq , OE “SINJALI” Sh.p.k nuk është deklaruar në lidhje me raportin e ekspertizës.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 07.07.2023 ka rekomanduar që:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “Sinjali” sh.p.k., me seli në Ferizaj.
- Të mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 13.06.2023(*vendim për dhënie të Kontratës*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues“Sinjali” sh.p.k

Ne konsiderojmë që AK gjatë kësaj procedure nuk ka respektuar në plotni legjislacionin për prokurim publik për arsyet si ne vijim, te cilat i kemi paraqitur edhe te kërkesat për rishqyrtim por prapë nuk janë përfillur nga AK. *Pra, konsiderojmë se është shkelur neni 1 Qëllimi i LPP-se- “Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla”.* AK ka rekomanduar për kontratë OE I cili ka nuk ka ofruar dokumentet adekuate sipas kërkesave te përshtatshmërisë. Ne fotografimë ne vijim, vërejmë se Operatori Select Prima sh.p.k. fatura nr. 001199 Pajjsja në faturë është “Rimorkio me shenja dhe drita” e jo “Gjysme Rimorkio Elektrike me Elemente Sinjalizuese”, siç kërkohet te kërkesat e përshtatshmërisë, Aneksi 7. I dosjes se tenderit. Një parregullsi tjetër është qe fatura nuk është ne emër te “Select Prima” sh.p.k., por ne emër te Idriz Pergjegjaj, gjë e cila te paktën do te duhej te argumentohej me

ndonjë autorizim apo marrëveshje për shfrytëzim të kësaj pajisje ndërmjet “Select Prima” sh.p.k. dhe Z. Idriz Pergjegjaj. Pra siç vërejmë edhe në faturën me poshtë, dokumenti nuk posedon as një informate të biznesit “Select Prima” sh.p.k., i cili sipas rregullave në fuqi do të duhej të kishte emrin e biznesit/blerësit, numrin Unik të regjistrimit të biznesit/blerësit si dhe adresën e biznesit/blerësit. Të gjitha këto elemente nuk janë të dokumentuara brenda dosjes së Operatorit Fitues “Select Prima” sh.p.k. Vërejtje: Faturat në emër të Idriz Pergjegjaj, e jo në emër të Select Prima sh.p.k. janë edhe Faturat: Nr. 001192 (Makinë për piketim), Fatura Nr. 001186 (Makinë për markim 2 komponent), Fatura Nr. 001192 (Makinë për Piketim) për të cilat do të duhej të veprimej njëjtë dhe të mos pranohen dëshmi që subjekti “Select Prima” i posedon pajisjet në fjalë me dokumentacione adekuate.

Njëra ndër dispozitat e shkelura është Neni 7, paragrafi 1,2,3,4 ligjit Nr. 04/L-042 ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjinnr.05/L-068dheLigjin Nr.05/L-092 përmes të cilit *"Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. 3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik. 4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik."*

Pra, ky nen obligon Autoritetin Kontraktues për trajtim të barabartë të ofertuesve. AK nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë Sinjal sh.p.k. në raport me Operatorin Fitues, pasi që në mungesë të dokumenteve apo në rast të dokumenteve jo adekuate AK do të duhej të analizonte dosjen e Sinjal sh.p.k. dhe ta trajtonte si operator të përgjegjshëm dhe ta rekomandonte për kontratë Operatorin Sinjal sh.p.k. Eksperti teknik, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit në sistemin e-prokurimi, shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës, pretendimeve të palës në ankesë ka nxjerrë këtë konkludim: Autoriteti Kontraktues ndër kërkesat për vlerësim përkatësisht tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofroj:

<p>Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.</p> <p>Vërejte OE duhet te demonstroj gjatë fazës së vlerësimit të komisionit të caktuar nga AK makineritë sipas kushteve të cekura më lartë dhe të njëjtat të duhet të verifikuar dhe të testohen në teren në prani të komisionit dhe të realizohet një pjese e sinjalizimit .</p>	<p>Një listë te pajisjeve dëshmuar me Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim</p>
--	---

Ndërsa në aneksin 7 janë kërkuar lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor gjegjësisht pozicioni 4 – Gjysmë rimorkio elektrike për sigurimin e vend punishtes gjatë realizimit të sinjalizimit.

Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve për sinjalizim horizontal të trafikut rrugor	Sasia e kërkuar (cope)
Makina special për sinjalizim horizontal a. Makine duhet te ketë kompjuterin me mundësi të programimit për punimin e vijës sipas kërkesës. b. Makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë term plastik dhe <u>sprej</u> për punimin e vijës me gjerësi <u>≥12 cm</u> deri <u>15 cm</u> si dhe trashësi <u>1 mm – 3 mm</u> ; c. Kapaciteti i ngjyrës <u>≥ 400 kg</u> ; d. Viti i prodhimit <u>≥ 2018</u> ; e. Motori <u>dizel</u> .	1
Makina special për sinjalizim horizontal a. Makina duhet të ketë mekanizmin për realizimin e vijave me ngjyrë <u>akrylike</u> për punimin e vijës me gjerësi <u>≥12cm</u> deri <u>15 cm</u> ; b. Kapaciteti i ngjyrës <u>≥ 200 kg</u> .	1
Makina special për piketim të rrugës	1
Gjysmë rimorkio elektrike për sigurimin e vend punishtesh gjatë realizimit të sinjalizimit	1
Kamion deri në 7.5 ton;	1

Eksperti teknik sqaron se OE si dëshmi për plotësimin e kësaj kërkesë ka ofruar një faturë, disa fotografi si dhe një kopje të vërtetuar nga noteri të dokumenteve origjinale me shenjë LRP.Nr.9712/ 2022, shiko dëshmitë në vijim:



Bazuar ne këto dëshmi shihet se OE ka plotësuar kërkesat e DT pasi që siç shihet edhe në foto pajisja është gjysmë rimorkio dhe e kryen funksionin për të cilin është e destinuar dhe nuk është relevante se çfarë emërtimi i është vendosur në fotografi përderisa pajisja për të cilën është kontestuar nga OE ankues është ajo që është kërkuar në dosjen e tenderit. Po ashtu fatura shihet se është ne emër të z. Përgjegjaj ku gjatë analizimit të dokumenteve z. Përgjegjaj rezulton se është person i autorizuar i operatorit “Select Prima” Sh.P.K gjegjësisht në pozitën e Drejtorit.

Prandaj, bazuar në sqarimet dhe dëshmitë e lartpërmendura rezulton se pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertëve profesional dhe teknik.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e e dy (2) ekspertëve shqyrtues profesional dhe teknik janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertëve shqyrtues të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër konkretisht nenin 59 dhe 60 të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshme ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertëve nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertëve shqyrtues profesional dhe teknik në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6 si dhe nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues nisat gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - SINJAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: